



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 1
Prishtinë, më 26. 12. 2014, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Teuta Rugova, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Ismet Beqiri.

Munguan: Elmi Reçica, Puhije Demaku, Ramush Haradinaj dhe Zafir Berisha.

Nga pjesëmarrësit e tjerë: Lumnije Murati – ZPRK dhe media.

Nga Zyra e Komisionit: Minire Hasani, Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Enver Hoxhaj, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Konstituimi i Komisionit për Punë të Jashtme;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

2. Konstituimi i Komisionit për Punë të Jashtme;

Enver Hoxhaj në takimin konstituiv të Komisionit , theksoi se Komisioni për Punë të Jashtme është formuar me vendim të mbledhjes plenare, të mbajtur më 18 dhjetor 2014, si dhe e prezantoi përbërjen e anëtarëve të Komisionit dhe strukturën e tij.

Kryetari tha se Komisioni do të punojë bazuar në Rregulloren e Kuvendit, ndërsa për takimet e Komisionit tha, se do të ishte mirë që anëtarët e Komisionit të përcaktohen se cilën ditë orientimisht do ta caktohet mbajtja e takimeve .

Ismet Beqiri theksoi se do të ishte mirë që Komisioni të përcaktohet orientimisht për ditën e mbajtjes së takimeve, e cila ndonjëherë do të mund të ishte edhe e lëvizshme, varësisht nga situata. Propozoj që ajo ditë, të mos jetë ditët e mbajtjes së seancave dhe e Kryesisë së Kuvendit.

Qerim Bajrami tha se ndihet i nderuar që është anëtarë i këtij Komisioni dhe shtoi se do të përpiqet të jap kontributin e tij maksimal. Ai njoftoi se vjen nga GP/6+ dhe se është anëtarë në tri komisione parlamentare, me ç'rast kërkoi mirëkuptim nga Komisioni, pasi mund të ndodh që të ketë në të njëjtën kohë edhe takime në komisionet e tjera.

Blerta Deliu-Kodra duke potencuar rëndësinë e politikës së jashtme për pozicionin e shtetit, tha se na presin mjaft punë dhe angazhime së bashku. Ajo propozoi që të gjendet një modalitet për terminin e mbledhjeve, në mënyrë që edhe subjektet e vogla që janë të përfshira në komisionet e tjera, të kenë mundësi të përcjellin gjithë punën e Komisionit.

Teuta Rugova propozoi që ditët e takimit të Komisionit të mbahen me marrëveshje, duke pasur parasysh deputetët që janë anëtarë në më shumë se një Komision, ndërsa shprehu dilemën se takimet e Komisionit mund të mbahen ditën kur mbahen mbledhjet plenare.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P e r f u n d i m

Konstituohet Komisioni FunkSIONAL për Punë të Jashtme, i formuar në mbledhjen plenare të mbajtur më 18 dhjetor 2014.

3. Të ndryshme.

Kryetari i Komisionit Enver Hoxhaj, njoftoi se mbledhja e radhës e Komisionit, e cila pritet të mbahet javën e tretë të janarit sipas Rregullores së Kuvendit, do të jetë më përmbajtjesore dhe do të diskutohet mbi planin dhe programin e punës së Komisionit për vitin 2015.

Ai shtoi se mbledhjet e Komisionit do të synohen të mbahen ditën e mërkurë, në parim, dhe se gjatë punës së Komisionit, pos tjerash, do t'i kushtohet rëndësi edhe bashkëpunimit me Komisionin për Integritet Evropian si dhe bashkëpunimit bilateral.

Mbledhja përfundoi në orën 11: 20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Enver Hoxhaj